



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBENIKA KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Dorëzuar Predato Delivery	05 - 05	2011	1	viti god year
Organ./Njësia Org./Unit	Nr./Prot: Br./Prot.No:	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPMSHCK	907/2011		1/3	

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBENIKA KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Bazuar në nenin 101 pika 2 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës dhe nenin 2 paragrafi 1.3 dhe nenit 22 të Ligjit Nr. 03\L-192 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli në mbledhjen e pestë (V) të mbajtur më datë 04.05.2011 miraton:

KODIN E ETIKËS

I. QËLLIMI

Ky Kod ka për qëllim që të shërbejë si udhëzues për sjelljen e të gjithë anëtarëve të Këshillit dhe ndihmon në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi, lidhur me veprimet e përditshme apo me ato vendimmarrëse, në përputhje me parimet që na udhëheqin, pra Kodi është mjet për të inkurajuar përmirësimin e qëndrimeve apo sjelljeve gjatë punës në Këshill.

II. FUSHËVEPRIMI

Kodi Etik i Këshillit është një përmbledhje e vlerave dhe parimeve, të cilave duhet të i'u përmbahen anëtarët e Këshillit gjatë punës së përditshme, duke u bazuar në ligjshmëri, ndershmëri, integritet, besueshmëri, profesionalizëm, punë të përbashkët në grup, sinqeritet dhe në besim reciprok, dhënien e mundësisë të zhvillimit të të gjithëve, respektimin e diversiteteve, inkurajimin e marrjes përsipër dhe të përballimit me sfidat, përgjegjësitë dhe vlerësimin e gjykimeve të publikut për veprimtarinë e Këshillit.

III. PARIMET E PËRGJITHSHME

a. Parimi i ligjshmërisë

Anëtari i Këshillit ushtron të gjitha funksionet dhe kompetencat në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ligjeve dhe instrumenteve të aplikuara ndërkombëtare.

b. Parimi i trajtimit të barabartë

Anëtari i Këshillit duhet t'i shmanget çfarëdo qëndrimi diskriminues, direkt apo indirekt, ndaj cilitdo anëtar të Këshillit dhe palëve të ndërlidhura me funksionet dhe kompetencat e Këshillit.

c. Parimi i ndershmërisë

Anëtarët e Këshillit duhet të tregojnë sjellje të besnikërisë ndaj Këshillit gjatë gjithë kohës me standard të lartë etik, respekt për njëri-tjetrin dhe palët, sinqeritet dhe transparencë.

d. Parimi i objektivitetit

Anëtarët e Këshillit duhet të veprojnë pa rënë në ndikim –shtytje të brendshme apo të jashtme, për vendimet që merren dhe detyrat që duhet t'i kryejnë, duke u bazuar në fakte–prova të analizuara dhe të arsyetuara.

e. Parimi i efikasitetit

Anëtarët e Këshillit duhet të sigurojnë zbatim të thjeshtë, ekonomik dhe transparent të rregullave për përmbushjen e objektivave të Këshillit.

f. Parimi i paanshmërisë

Anëtari i Këshillit duhet të veprojë me paanshmëri dhe të mos komprometojë apo të duket se komprometon rezultatet e detyrave të ngarkuara apo interesat e Këshillit. Sjellja zyrtare duhet të karakterizohet gjithnjë nga objektiviteti dhe profesionalizmi. Nuk lejohet që marrëdhëniet apo konsideratat personale, përshirë këtu edhe paragjykimet, njëanshmëritë apo favorizimet, të ndikojnë në rezultatet e detyrave zyrtare.

T'i shërbejë Këshillit, pavarësisht prej ndikimeve politike, të veprojë në mënyrë meritore me qëllim të krijimit, ruajtjes dhe të nxitjes së besimit të publikut për dinjitetin, integritetin dhe pavarësinë e Këshillit.

g. Parimi i shmangies të konfliktit të interesit

Anëtari i Këshillit duhet të shmangë çdo lloj konflikti të interesit, të mundshëm, të bazuar në marrëdhëniet familjare ose shoqërore, në marrëdhëniet e tjera profesionale ose financiare. Nëse, për çfarëdo arsye, anëtari i Këshillit nuk është në gjendje që të veprojë në përputhje me parimin e paanshmërisë, ai/ajo), duhet të ndër marrë veprim të menjëhershëm, duke përfshirë edhe heqjen dorë nga rasti dhe të kërkojë nga Kryetari ose Këshilli për ta liruar nga rasti.

Anëtari i Këshillit nuk duhet të vendosë lidhur me ankesat ose të marrë çfarëdo vendimi tjetër në detyrën e vet zyrtare, nëse është në dijeni ose në mënyrë të arsyeshme është dashur të dijë se ky vendim përbën konflikt interesi.

Anëtari i Këshillit nuk duhet të përdorë pozitën e vet për të ushtruar ndikim në vendimet e personave të tjerë në mënyrë që të arrijë dobi për interesin e vet privat.

Anëtari i Këshillit ose anëtari i familjes së tij, nuk duhet të pranojë dhuratë ose çfarëdo avantazhi tjetër nga personat që kanë interes direkt ose indirekt për rastin në shqyrtim, dhe që në mënyrë të arsyeshme mund të shihen si rezultat i trajtimit të favorizuar të atij personi ose etniteti.

IV. SJELLJA ETIKE NË MES SEKRETARIATIT DHE ANËTARËVE TË KËSHILLIT

Sjellja në mes të Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit me nëpunësit civilë të Sekretariatit të Këshillit, rregullohet, sipas parimeve të përgjithshme të Kodit të Mirësjelljes për Nëpunësit Civilë dhe dispozitave të tjera, të cilat e rregullojnë sjelljen e nëpunësve civilë ndaj zyrtarëve të emëruar publikë.

V. PËRGJEGJËSIA E MOSZBATIMIT

Anëtari, i cili bie ndesh me këtë Kod gjatë punës së tij në Këshill, Këshilli duhet të marrë vendim me shumicë votash të të gjithë anëtarëve për ta paraqitur rastin në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

VI. HYRJA NË FUQI

Ky Kod hynë në fuqi pas miratimit nga ana Këshillit dhe nënshkrimi nga Kryetari i Këshillit.

Mehdi GECI
Kryetar i Këshillit
Datë 04.05.2011

